



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 8026

Prot

Tirane, 03/04/2017

UDHËZIM

Nr. 02 datë 03/04/2017

**“MBI PROCEDURAT PËR TRAJTIMIN E KAFSHËVE TË GJALLA PËR MAJMËRI”**

Mbështetur në Ligjin Nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM Nr. 205, datë 13.04.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor” të ndryshuar, VKM Nr. 921 datë 29.12.2014 “Për Personelin e Administratës Doganore”, të ndryshuar, Ligjin Nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, nenet 14, 44/1, 54/40, 86/5, 90, 111 dhe 158/2 dhe “Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr. 6, datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 51/10;

Me qëllim zbatimin korrekt dhe unifikues të procedurave të përjashtimit nga TVSH të Kafshëve të Gjalla për Majmëri;

Me qëllim thjeshtimin e procedurave për importimin dhe konfirmimin e natyrës së mallrave Kafshë të Gjalla për Majmëri nga autoritetet doganore, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave,

UDHËZON:

**I. KUSHTET E PËRGJITHSHME**

1. Kodet tarifore të Kafshëve të Gjalla për Majmëri (KPM) për të cilat zbatohet përjashtimi nga TVSH, janë të evidentuara në pikën 10 të nenit 51 të “Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 6, datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
2. Mbajtësi i autorizimit KPM është i detyruar:
  - t’i përdorë mallrat për qëllimin e caktuar të majmërisë dhe brenda afatit të përcaktuar në autorizimin e KPM<sup>se</sup>,
  - të mbajë regjistra për mallrat e importuara me autorizimin KPM,
  - t’i mundësojë autoriteteve doganore kryerjen e çdo kontrolli dokumentar ose fizik.

3. Mbajtësi i autorizimit duhet të njoftojë autoritetet doganore për të gjithë faktorët që lindin pas dhënies së autorizimit dhe që mund të ndikojnë në vijueshmërinë e tij.
4. Kafshët e Gjalla për Majmëri të çliruara në qarkullim të lire, me TVSH importi të përjashtuar, mbeten nën mbikëqyrjen doganore. Kjo mbikëqyrje përfundon në rastet e mëposhtme:
  - përmbushet afati i mbikëqyrjes së KPM<sup>së</sup> sipas autorizimit;
  - kushtet për përfitimin e përjashtimit nga TVSH pushojnë se ekzistuari dhe paguhet TVSH përkatëse;
  - kur mallrat eksportohen ose asgjësohen ose theren në mënyrë të sforcuar;
  - kur lejohet përdorimi i mallrave për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara për zbatimin e përjashtimit nga TVSH dhe paguhet TVSH përkatëse.
5. Proçedura e trajtimit me TVSH të përjashtuar për KPM quhet e mbyllur kur autoritetet doganore binden se mallrat (KPM) të importuara janë përdorur për qëllimin e caktuar të majmërisë.
6. Me qëllim përshpejtimin e proçedurave të zhdoganimit, deklarata e eksportit dhe dokumentacioni i transportit mund të mos kërkohet të depozitohet paraprakisht (*në momentin e kërkesës për Autorizimin KPM*), por duhet të jetë pjesë e praktikës doganore në momentin që mallrat janë në Degë Doganore Kufitare.
7. Modeli i autorizimit KPM<sup>së</sup> është sipas formatit të Aneksit I, bashkëngjitur këtij udhëzimi.
8. Në rast se autorizimi është lëshuar vetëm për një import, afati i autorizimit KPM është deri në datën kur pritet të mbërrijë ngarkesa. Nëse autorizimi është lëshuar për një sasi kërresh, të parashikuar për t'u importuar në disa ngarkesa të mëvonshme, afati mund të jetë më i gjatë, por jo më shumë se një vit.

## II. KUSHTE TË VEÇANTA

1. Personi i interesuar (operatori/importues) paraqet, para ose në momentin e importit, në Degë Doganore Kufitare kërkesën për autorizimin KPM sipas formatit të Aneksit 2 (bashkëngjitur). Kërkesa duhet të përmbajë emrin dhe adresën e kërkuarit, numrin e NUIS<sup>it</sup>, adresën e ambientit të stabilimentit të rritjes për majmëri, kodin tarifor dhe sasinë e kafshëve të cilat do të importohen.
2. Kërkesës duhet t'i bashkëngjiten dokumentet shoqëruese të importit dhe konkretisht:
  - vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore se ushtron aktivitet në fushën e bujqësisë dhe peshkimit;
  - vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë se importuesi ka stabiliment të rritjes për majmëri të kafshëve të gjalla;
  - fatura proformë / fatura,
  - çertifikata fitosanitare (nga vendi eksportues),
  - lista e detajuar me të dhënat për emrin, moshën, mbarëse apo jo (*për kafshët*),

- dokumente që vërtetojnë origjinën,
  - fotokopje NUIS<sup>it</sup>, Licencës së QKL.
3. Kërkesa për autorizim së bashku me dokumentacionin shqyrtohet me prioritet nga Dega Doganore Kufitare dhe nëse është e rregullt lëshon autorizimin KPM. Në rast refuzimi të miratimit kërkuesi njoftohet me shkrim menjëherë për arsyet e këtij refuzimi.
  4. Kafshët e gjalla duhet të përdoren për qëllimin e veçantë të majmërisë brenda afatit të parashikuar sipas kërkesës dhe të përcaktuar në pikën 6, të autorizimit.
  5. Kafshët e gjalla dhe dokumentacioni i tyre i nënshtrohen gjithmonë kontrollit nga AKU, në përputhje me Ligjin nr.10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar”, të ndryshuar.
  6. Dokumentacioni shoqërues, i detyrueshëm për t’u plotësuar në sistemin informatik të Doganës, (Asycuda World), në momentin e deklarimit, sipas kodeve të dokumenteve, është si vijon:

853 Çertifikata veterinare nga AKU  
928 Autorizimi i KPM

### III. MBIKQYRJA DHE SHKËMBIMI I INFORMACIONIT

1. Dega Doganore Kufitare (zyra e regjimeve dhe akcizës) për çdo operator/importues që ka përfituar autorizim KPM, krijon dosje të veçantë e cila duhet të përmbajë:
  - një kopje të autorizimit;
  - kartelën e të dhënave të kafshëve të gjalla;
  - formularët (procesverbalet) e inspektorit të kontrollit veterinar;
  - të gjitha akt-kontrollet e kryera në lidhje me mbikëqyrjen e KPM në fjalë.

Dega Doganore Kufitare një kopje të dosjes (në rrugë elektronike email) e dërgon pranë Degës Doganore Mbikqyre të stabilimentit të operatorit/importuesit (sipas kompetencës territoriale) për t’u trajtuar nga zyra e regjimeve dhe akcizës.

Autorizimet KPM, dërgohen për t’u regjistruar në sistemin informatik të Doganës në rrugë elektronike (e-mail:s\_tarifa@dogana.gov.al), pranë Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës në DPD, Sektori i Tarifës.

2. Trajtimi me TVSH të përjashtuar i KPM konsiderohet i mbyllur, me përmbushjen e afatit të mbikëqyrjes përcaktuar në pikën 6 të autorizimit dhe me dorëzimin pranë Degës Doganore Mbikqyrëse ku është vendosur stabilimenti ose pranë Degës Doganore Kufitare që ka lëshuar autorizimin, të Vërtetimit të Kontrollit Fizik të Kafshëve, me numrat e matrikulimit, të lëshuar nga struktura kompetente e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Ky vërtetim konfirmon nëse kafshët janë gjallë dhe janë përdorur për qëllimin e majmërisë.
3. Në rastet e “therjeve të detyrueshme” (kur therja është e pashmangshme për shkak të ndonjë sëmundje, ose shkak i njohur si i tillë nga autoritet veterinar) pranë Degës Doganore Mbikqyrëse të Stabilimentit ose pranë Degës Doganore Kufitare që ka lëshuar

autorizimin duhet të depozitohet nga operatori/importuesi procesverbalet përkatës të therjes të detyrueshme të cilat i bashkëlidhen dosjes.

4. Dega Doganore Kufitare, sipas analizës së riskut, kryen kontrole dokumentare apo fizike, kur gjykohet dhe është e mundur në bashkëpunim me AKU, me qëllim verifikimin e deklaramit të operatorit/importuesit në momentin e zhdoganimit.
5. Dega Doganore Mbikëqyrëse e stabilimentit, kryen kontrole dokumentare, fizike, periodike apo të papritura me qëllim që të sigurohet se mallrat e çliuara për qarkullim të lirë me TVSH të përjashtuar, janë përdorur për qëllimin e majmërisë. Kur gjykohet dhe është e mundur këto kontrole kryhen në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale Tatimore përkatëse.

Dega Doganore Mbikëqyrëse e stabilimentit për çdo dokument që depozitohet pranë saj nga operatori/importuesi që ka përfituar autorizim KPM informon Degën Doganore Kufitare që ka lëshuar autorizimin KPM. Gjithashtu Dega Doganore Mbikëqyrëse informon Degën Doganore Kufitare që ka lëshuar autorizimin KPM për çdo kontroll që kryen dhe për parregullsitë e konstatuara dhe vendimet e marra.

6. Në datën 5 të çdo muaji, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave i dërgon zyrtarisht Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve listën e importuesve të kafshëve të gjalla, sasi të dhe vlerën, të kafshëve të gjalla për majmëri të importuara.

#### IV. DISPOZITA TË FUNDIT

Ky udhëzim hyn në fuqi më 31.03.2017 dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

**Belinda IKONOMI**

**DREJTOR I PERGJITHSHEM**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
Dega Doganore \_\_\_\_\_

Nr. Prot. \_\_\_\_\_, më \_\_\_\_\_ 20\_\_

**Autorizim përjashtimi nga TVSH Nr. \_\_\_\_\_  
(Për Kafshët e Gjalla për Majmëri)**

**1. Mbajtësi i Autorizimit:**

*Emri:*

*Nipti/NUIS:*

**2. Adresa e plotë e stabilimentit/fermës \_\_\_\_\_**

**3. Qëllimi i përdorimit "MAJMËRI"**

**4. Periudha e vlefshmërisë së autorizimit**

*Ky autorizim është i vlefshëm deri më ... / ... / ...*

**5. Mallrat të cilat do të vendosen nën mbikëqyrje doganore:**

Kodi tarifor	Përshkrimi	Sasia

**6. Periudha e mbikëqyrjes doganore**

Deri në datë ... / ... / ... (Jo më pak se periudha e karantinës)

**7. Identifikimi i përdorimit të veçantë:**

*Nëpërmjet:*

- Vërtetimit të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë
- Vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore

**Shënime :** Mbajtësi i autorizimit duhet të njoftoj autoritetin doganore nëse ndryshon një apo disa nga kushtet e autorizimit.

**KRYETARI I DEGËS DOGANORE**

Drejtuar: Degës Doganore \_\_\_\_\_

Lënda: Kërkesë për Përjashtim nga TVSH për Kafshë të Gjalla për Majmëri

Unë i nëshkruari, ..... me Nr. NUIS<sup>1</sup>:  
..... dhe me adresë  
.....  
kërkoj miratimin për Përjashtimin nga TVSH për Kafshë të Gjalla për Majmëri, si vijon:

**1. Mallrat/Kafshët të cilat do të përjashtohen nga TVSH:**

Kodi tarifor	Përshkrimi	Sasia

**2. Arsyet e kërkesës për përjashtim** .....

**3. Periudha kohore e majmërisë** .....

**4. Periudha kohore e karantinës** .....

**5. Periudha kohore e autorizimit**.....

**6. Dokumentet bashkëngjitur:**

- vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore se ushtron aktivitet në fushën e bujqësisë dhe peshkimit;
- vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë se importuesi ka stabiliment të rritjes për majmëri të kafshëve të gjalla;
- fatura proformë / fatura,
- çertifikata fitosanitare (nga vendi eksportues),
- lista e detajuar me të dhënat për emrin, moshën, mbarëse apo jo (për kafshët),
- dokumente që vërtetojnë origjinën,
- fotokopje NUIS<sup>1</sup>, Licencës së QKL,

**ADMINISTRATORI**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_